



Dt.12.07.2024

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 68 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040,(Gazeta Zyrtare) Nr.28/2008), në bazë të dispozitave të nenit 7,8, dhe 9 të Ligjit për Vlerësim Strategjik Mjedisor me Nr.03/L-230, neni 28 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit 03/L-25 , i cili parasheh Vlerësim Strategjik Mjedisor si proces të ndikimit të mundshëm në mjedis të një politike plani apo programi që parasheh mbajtjen e konsultimeve, marrjen parasysh të raportit dhe rezultatet të konsultimeve në vendimmarrje, si dhe vendimit të Kuvendit Komunal me Nr.06-21104/21 të dt. 01.07.2021 për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2024-2032.

NJOFTIM

PËR HAPJEN E SHQYRTIMIT PUBLIK TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR

Me qëllim të inkurajimit të qytetarëve dhe të transparencës të përbushjes së detyrimeve ligjore, njoftojmë të gjithë të interesuarit se nga data 15.07.2024 deri më 15.08.2024, Komuna e Klinës do të zhvillojë shqyrtim publik për draft dokumentin e vlerësimit strategjik mjedisor si dokument i cili inkorporohet në Planin Zhvillimor Komunal 2024-2032.

Draft dokumenti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor i Komunës së Klinës është dërguar për rekomandim pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Departamentin e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave, i cili ky i fundit ka rekomanduar të organizohet shqyrtimi publik sipas akteve dhe dispozitave ligjore.

Sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor, shqyrtimi publik zgjat 30 ditë, dhe gjatë kësaj periudhe, profesionistët, grupet e interesit dhe qytetarë të interesuar mund të dorëzojnë vërejtjet , sugjerimet dhe propozimet e tyre në emailin zyrtar: në web faqen e Komunës së Klinës si dhe të grupit punues për pranimin dhe shqyrtimin e vërejtjeve dhe sugjerimeve të bëra nga ana e personave fizik dhe juridik, si dhe në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, kati 1, objekti i Komunës së Klinës , sheshi ‘‘Mujë Krasniqi’’.

Qëllimi i organizimit të shqyrtimit publik si pjesë e procesit të Hartimit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor është që të pranohen dhe vlerësohen komentet (vërejtjet dhe sugjerimet) të cilat shërbejnë për ngritjen e cilësisë së dokumentit, para dorëzimit të tij për miratim përfundimtar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe në Kuvendin e Komunës.

Takimi i debatit publik do të organizohet më datë 02.08.2024 në ora 14:00 në sallën e Kuvendit Komunal Klinë.

Të gjitha palët e interesuara, dokumentin kopjen fizike mund ta tërheqin në ambientin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Grupi punues është përgjegjës për shqyrtimin e propozimeve dhe kërkesave të palëve të interesit. Draft dokumenti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal 2024-2032 është publikuar në web faqen www.KomunaKline.org si dhe në sallën e Konferencave, kati II, ndërtesa e Komunës së Klinës , Sheshi ‘‘Mujë Krasniqi’’.

Njoftimi për hapjen e shqyrtimit publik vendoset në tabelën e shpalljeve në ndërtesën e Komunës, në mjete të informimit dhe në web faqen e Komunës së Klinës.

Personat kontaktues për komente:

Vlora Tafili, vlora.tafili@rks-gov.net

Dardan Bashota, dardan.bashota@rks-gov.net

Me respekt

